



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 553/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.12.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Saer Medical” shpk në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-71877-09-15-2020, me objekt “Blerje pajisjesh për Shërbimin e sallave të Ortopedisë në SUT”, me fond limit 7.979.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 14.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

Ankimues: “Saer Medical” sh.p.k.
Adresa: Rruga “Themistokli Gërmenji”, Pallati. 11, Shk. 4, Ap. 5, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Spitali Universitar i Traumës.
Adresa: Rruga: “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për

miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Autoritetit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.09.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-71877-09-15-2020, me objekt “Blerje pajisjesh për Shërbimin e sallave të Ortopedisë në SUT”, me fond limit 7.979.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 14.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

II.2 . Në datën 14.10.2020 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 21.10.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të

Vlerësimet të Ofertave, si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton si më poshtë vijon:

1. “Saer Medical” sh.p.k	5,200,000 lekë	skualifikuar
2. “Fedos” shpk	5,300,000 lekë	kualifikuar
3. “Medafu” shpk	6,000,000 lekë	skualifikuar
4. “OES Distrimed” shpk	7,639,000 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 21.10.2020 operatori ekonomik “Saer Medical” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik nuk ploteson piken 2.3 Kapaciteti Teknik ne pikat: o, p, s, t, x, hh, jj, ll, mm, nn, oo, Modaliteti Radiografi ne pikat: b, ii, iii, iv, v, vi

Diapazoni i mAs jo më pak se: 1-250mAs. Nuk e ka te shprehur

Të ketë lëvizje vertikale të motorizuar deri në 45cm. 400 mm

Të ketë lëvizje horizontale deri në 210mm. 200 mm

Të ketë lëvizje lëkundese deri në ±12 o. ±10.5 o

Të ketë filtrim shtesë të fiksuar, jo më pak se 1 mmAl 0.7 mmAL

Raporti i kontrastit ndaj sipërfaqes së madhe të jetë: 23:1, 25:1, 30:1. 33:1, 42:1, 61:1

Faktori i konvertimit të jetë të paktën 240 Cd/m²/mR/s. 235 Cd/m²/mR/s

Të ketë jo më pak se 620 linja dhe frekuence 50 Hz. Nuk e ka te shprehur

Të jetë me persistence të ulët. Nuk e ka te shprehur

Raporti i aspektit të jetë 4:3 dhe brezi jo më pak se 14 MHz. Nuk e ka te shprehur

Të jetë me sensor CCD 1/2”. Sensor CMOS

Modaliteti Radiografi

Të mund të komandohen rrezet X në distance me kabull deri në 4 m. Mungon gjatesia 4 m

Temperatura maksimale e tubit të rrezeve X.

mA minimale dhe mA maksimale.

Koha maksimale e ekspozimit.

Rryma në filament.

Rrotullimi I anodës.

Vetëkontroll të mikroprocesorit. Nuk i ka te shprehura.

II.4.1. Në datën 26.10.2020, operatori ekonomik ankimes “Saer Medical” shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e mësipërme e prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

Te nderuar Zoterinj!

U njohem nepermjet faqes se A.P.P.-se me vendimin e KVO per shpalljen e klasifikimit te ofertave te paraqitura per objektin e prokurimit ne fjale.

Ju lutem na lejoni te sjellim ne vemendjen tuaj pikat tona same poshte vijon :

- *Kompania e cila eshte shpallur fituese e kesaj gare eshte nje kompani e cila trajton vetem prodhime te nje niveli mjaft te dobet aziatik, me performance shume te ulet, aspak me kerkesat aktuale te kohes dhe qe fatkeqesisht mjaft shpejt do te qendroje diku i stivosur ne magazinat e Spitalit Universitar te Traumes.*

- *Ne listen e “argumentimit” teknik te refuzimit te ofertes se paraqitur nga ana jone, specialistet tuaj perpiqen dhe rreken te listojne nje sasi te madhe specifikimesh teknike te “papermbushura” te cilat te krijojne ne pamje te pare pershtypjen qe vleresimi i kryer nga ana e KVO ka qene i drejte dhe aspak diskriminues per operatoren pjesemarres.*

- *KVO nuk ka marre as mundimin me te vogel per te paraqitur kerkesa per sqarim per ato specifikime te cilat sipas tyre nuk gjenin anje lloj pasqyrimi ne katalogun e paraqitur nga ana jone. Me kete logjike i bie qe asnje prodhues prestigjioz ne bote nuk mund te “konkurroje” me specifikime prodhuesin “e shkelqyer” aziatik (te cilin ju si Autoritet doni qe ta beni me doemos fitues te kesaj procedure). Ne qofte se qenkerka keshtu atehere si shpjegohet qe ky prodhues nuk arrin qe te shese keto produkte ne spitalet prestigjioze perendimore? Mos valle eshte qe stafi i tyre nuk eshte ne gjendje te dalloje performancen e ketij prodhuesi apo mos valle arrijne qe te bejne dallimin dhe te kuptojne me se miri cilesine dhe performancen e dobet te ketij prodhuesi dhe prodhimeve te tij.*

- *Duke iu rikthyer “argumentimeve” te paraqitura nga ana juaj, ju lutem na saktsoni se cfare diference sjell ne performancen e pajisjes fakti qe levizja vertikale eshte 40 cm ne vend qe te jete 45 cm ? Cfare diference sjell levizja horizontale nga 200 mm ne 210 mm? Cfare diference sjell ne performance sjell faktori i konvertimit nga 235 ne 240 Cd /m²/ mR/s ? Ju themi me plot bindje qe nuk ka asnje ndryshim, madje nuk mund te konsiderohen as devijime te vogla. Keto specifikime jane kontestuar dhe nuk eshte bere asnje lloj shpjegimi.*

- *Ne kete liste thuhet qe :*

A. Nuk arrijme dot qe te kemi 620 linja me frekuence 50 Hz kur nderkohe kemi 1024xl 024 pixels @ 30 imazhe per sekonde.

B. Ne kete liste thuhet qe nuk kemi Persistence te ulet kur nderkohe e kemi.

C. Ne kete liste thuhet qe nuk kemi kablo 4 metra kur nderkohe e kemi.

D. Ne kete liste thuhet qe nuk kemi CCD 1/2 kur nderkohe kemi CMOS e cila eshte teknologji me e mire. Ju lutem shihni edhe shpjegimin me te thjeshte qe mund te gjeje kushdo ne google: Which is better CMOS or CCD?

CMOS sensors have thousands. This means that CMOS cameras can read out incredibly fast, even JOOX faster than a comparable CCD. For long-exposure applications that is not so important; but it is especially important for video camera !!!!!!!

E. Raporti i kontrastit te jete 23:1, 25:1, 30:1, 33:1, 42:1, 62:1, nderkohe qe e kemi 33:1 - 22:1; 42:1 - 24:1, 61:1 - 30:1, 40:1 - 23:1

F. Raporti i aspekti te jete 4:3 dhe brezi jo me pak se 14 MHz kur ne fakt ne e kemi raportin 4:3 dhe me 1000 Mbit/s

G. Te kete filtrim shtese te fiksuar dhe jo me pak se 1 mm : Filtrimi total 3,9 mm Al, (shuma e filtrimit Al te vendosur dhe atij te fiksuar shtese).

H. Te kete te pakten keto nivele sigurie: Temperatura maksimale e llambes, koha maksimale e ekspozimit, Rryma ne filament, rrotullimi i anodes, vetekontroll te mikroprocesorit; Te gjitha keto kërkesa prodhimi i paraqitur nga ana jonë i ka.

I. Brezi i mAs te jete 1-250 mA kur nderkohe ne kemi brezin e rrymes 25-100 mA dhe kushdo mund te beje nje shumezim mjaft te thjeshte dhe te konstatoje se per nje ekspozim prej 2,5 s aparati arrin qe te emetoje 250 mAs.

Komentet e metejshme mbeten te teperta dhe kemi bindjen e plote ne argumentet e paraqitura nga ana jone.

II.4.2. Në datën 30.10.2020 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 2111/1 i kthen përgjigje palës ankimuese “*Saer Medical*” shpk duke vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik.

II.4.3. Në datën 06.11.2020 operatori ekonomik ankimues “*Saer Medical*” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Me shkresën nr. 2226/1 prot, datë 24.11.2020 protokolluar me tonën me nr. 1437/2 prot. datë 01.12.2020, me objekt “*Informacion*”, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentacioni i paraqitur nga autoriteti kontraktor për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “*Saer Medical*” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen se: “*Operatori ekonomik nuk ploteson piken 2.3 Kapaciteti Teknik ne pikat: o, p, s, t, x, hh, jj, ll, mm, nn, oo, Modaliteti Radiografi ne pikat: b, ii, iii, iv, v, vi*

Diapazoni i mAs jo më pak se: 1-250 mAs.

Të ketë lëvizje vertikale të motorizuar deri në 45cm.

Të ketë lëvizje horizontale deri në 210mm.

Nuk e ka te shprehur

400 mm

200 mm

<i>Të ketë lëvizje lëkundese deri në ±12 o.</i>	<i>±10.5 o</i>
<i>Të ketë filtrim shtesë të fiksuar, jo më pak se 1 mmAl</i>	<i>0.7 mmAL</i>
<i>Raporti i kontrastit ndaj sipërfaqes së madhe të jetë: 23:1, 25:1, 30:1.</i>	<i>33:1, 42:1, 61:1</i>
<i>Faktori i konvertimit të jetë të paktën 240 Cd/m2/mR/s.</i>	<i>235 Cd/m2/mR/s</i>
<i>Të ketë jo më pak se 620 linja dhe frekuence 50 Hz.</i>	<i>Nuk e ka te shprehur</i>
<i>Të jetë me persistence të ulët.</i>	<i>Nuk e ka te shprehur</i>
<i>Raporti i aspektit të jetë 4:3 dhe brezi jo më pak se 14 MHz.</i>	<i>Nuk e ka te shprehur</i>
<i>Të jetë me sensor CCD 1/2”.</i>	<i>Sensor CMOS</i>
<i>Modaliteti Radiografi</i>	
<i>Të mund të komandohen rrezet X në distance me kabull deri në 4 m.</i>	<i>Mungon gjatesia 4 m</i>
<i>Temperatura maksimale e tubit të rrezeve X.</i>	
<i>mA minimale dhe mA maksimale.</i>	
<i>Koha maksimale e ekspozimit.</i>	
<i>Rryma në filament.</i>	
<i>Rrotullimi I anodës.</i>	
<i>Vetëkontroll të mikroprocesorit.</i>	<i>Nuk i ka te shprehura.”,</i>
<i>Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:</i>	

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 8/2, “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 2.3.f, “*Kapaciteti teknik*” të dokumentave të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.f. Kataloge per artikujt e ofruar ku te perfshihen edhe specifikimet teknike per artikullin e kerkuar. OE duhet te markoje ne katalogun perkates paisjen qe ofron sipas numrit rendor te percaktuar ne formularin e ofertes. Kataloget do te pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

III.1.2. Në dokumentat e tenderit, shtojca 9 e modifikuar, “*Specifikimet teknike*”, të dokumentave të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

ISHTE:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Operatori ekonomik duhet të ketë Autorizim për shit-blerje të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë.

1) C-ARM

- a. *C-Arm për disa mënyra fluoroskopike dhe radiografi me kaseta.*
- b. *Të ketë përpunim dixhital të imazheve.*
- c. *Të mundësoj imazhe me format të paktën 570*570* 8 bit.*

- d. Të ketë kapacitet memorizimi për të paktën 300 imazhe.
- e. Invertimi Horizontal-Vertikal të realizohet në të dy mënyrat e përpunimit të imazhit.
- f. Të ketë reduktim të zhurmave dhe filter rekursiv gjatë përpunimit në kohë reale të imazhit.
- g. Të ketë 2 monitor LCD, jo më të vogël se 19"
- h. Ndërfaqja e përdoruesit të jetë me prekje për vendosjen e parametrave dhe afishimin e mesazheve.
- i. Të kontrollohet me mikroprocesor.
- j. Me frekuence 40kHz dhe diapason tensioni 40-120kV.
- k. Rryma e monoblokut të jetë deri në 7mA në fluoroskopi dhe deri në 65mA në radiografi.
- l. Rryma në fluoroskopi me goditje të jetë 12mA.
- m. Të jetë me gjenerator monofaze me tension 220-230V, me kompesim automatik të linjës.
- n. Fuqia jo me pak se 3.5kE.
- o. Rrotullimi lateral jo më pak se: 1-250mAS.
- p. Të ketë lëvizje vertikale të motorizuar deri në 45cm.
- q. Lëvizja orbitale të arkut deri në 130°.
- r. Hapësira e përdorueshme midis tubit të rrezeve X dhe intesifikuesit të imazhit, jo më pak se 72cm.
- s. Të ketë lëvizje horizontale deri në 210mm.
- t. Të ketë lëvizje lëkundese deri në $\pm 12^\circ$.
- u. Thellësia e arkut jo më pak se 65cm.
- v. Kapaciteti termik i monoblokut, jo më pak se 880kJ.
- w. Të ketë filtrim total me të madh se 2.7mmAl
- x. Të ketë filtrim shtesë të fiksuar, jo më pak se 1 mmAl
- y. Shpërndarja termike e monoblokut, jo më pak se 60W
- z. Të jetë me kolimator virtual.
- aa. Anode rrotulluese më jo më pak se 3000 rmp.
- bb. Të ketë përmasa fokale 0.3*0.3mm me 0.6*0.6mm.
- cc. Diafragram të kontrollohet nga konsola e komandimit me rregullim të vazhdueshëm.
- dd. Të ketë dy mbyllëse paralele të diafragmës, me rrotullim dhe hapje të ndryshme.
- ee. Të jetë jo më pak se 9" dhe zmadhimi në të paktën 3 zona.
- ff. Grila e intesifikuesit të imazhit me raport jo më pak se 8:1.
- gg. Diametri i imazhit në dalje të jetë jo më i vogël se 19mm.
- hh. Raporti i kontrastit ndaj sipërfaqes së madhe të jetë: 23:1, 25:1, 30:1.
- ii. Efikasiteti kantik i gjurmimit të jetë sipas standartit IEC.
- jj. Faktori i konvertimit të jetë të paktën 240 Cd/m²/mR/s.
- kk. Mbyllësi i diafragmës deri në 40L/cm.
- ll. Të ketë jo më pak se 620 linja dhe frekuence 50 Hz.
- mm. Të jetë me persistence të ulët.
- nn. Raporti i aspektit të jetë 4:3 dhe brezi jo më pak se 14 MHz.
- oo. Të jetë me sensor CCD 1/2".
- pp. Të ketë modalitet e funksionimit radiografi dhe fluoroskopi.

➤ *Modaliteti i fluoroskopit:*

- a. *Të ketë teknikën me 1 pike për kontroll manual të tensionit dhe kontroll automatik të rrymës.*
- b. *Të ketë teknikën me 0 pika për kontroll automatik të rrymës dhe tensionit.*
- c. *Të mund të komandohen rrezet X në distance me pedal multifunksional.*

➤ *Modaliteti Radiografi:*

- a. *Të ketë teknikën 2 pika (Kv dhe mAs).*
- b. *Të mund të komandohen rrezet X në distance me kabull deri në 4 m.*
- c. *Të ketë komutues dore me shkallë të dyfishtë.*
- d. *Të paktën nivelet e mëposhteme të sigurise:*
 - i. *Temperatura maksimale e tubit të rrezeve X.*
 - ii. *mA minimale dhe mA maksimale.*
 - iii. *Koha maksimale e ekspozimit.*
 - iv. *Rryma në filament.*
 - v. *Rrotullimi I anodës.*
 - vi. *Vetëkontroll të mikroprocesorit.*

Të shoqerohet me të gjithë aksesorët e nevojshem për funksionimin normal të të gjithë parametrave të pajisjes.

2. Përparse plumbi.

Përparse plumbi përberë nga:

- i. *Xhaketë plumbi, permasa L. Të dy anët e xhaketës për mbrojtje nga rrezet radioactive, shtresa e përparme mbrojtëse jo më pak se 0.50mm, shtresa e mbrapme mbrojtëse jo më pak se 0.25mm.*
- ii. *Fund plumbi, permasa L. Të dy anët e fundit për mbrojtje nga rrezet radioactive, shtresa e përparme mbrojtëse jo më pak se 0.50mm, shtresa e mbrapme mbrojtëse jo më pak se 0.25mm.*
- iii. *Qafore plumbi për mbrojtjen nga rrezet radioactive, shtresa mbrojtëse jo më pak se 0.50mm, qaforja e përshtatëshme për përmasat 38-46, lartësia e qaforës 6 cm.*

3. Pajisje pneumatike për ndaljen e gjakut.

- i. *Të jetë me manometer me shkallë jo më pak se 690 mmHg.*
- ii. *Të ketë pompë pneumatike për fryrjen.*
- iii. *Të jetë me dy mansheta, për krah dhe në kofshe.*

Paisjet e mesiperme duhet te jene cilesore dhe te certifikuara sipas standarteve CE.

Paisjet duhet te kene garanci per te pakten nje vit duke filluar nga data e furnizimit te tyre.

Afati i levrimit te mallrave duhet te jete brenda dy muajve duke filluar nga data e lidhjes se kontrates se furnizimit. Sipermarresi duhet te siguroje transportin deri ne montimin dhe venien ne funksion te paisjeve.

BEHET:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Operatori ekonomik duhet të ketë Autorizim për shit-blerje të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë.

2) **C-ARM**

- a. C-Arm për disa mënyra fluoroskopike dhe radiografi me kaseta.
- b. Të ketë përpunim dixhital të imazheve.
- c. Të mundësoj imazhe me format të paktën 570*570* 8 bit.
- d. Të ketë kapacitet memorizimi për të paktën 300 imazhe.
- e. Invertimi Horizontal-Vertikal të realizohet në të dy mënyrat e përpunimit të imazhit.
- f. Të ketë reduktim të zhurmave dhe filter rekursiv gjatë përpunimit në kohë reale të imazhit.
- g. Të ketë 2 monitor LCD, jo më të vogël se 19"
- h. Ndërfaqja e përdoruesit të jetë me prekje për vendosjen e parametrave dhe afishimin e mesazheve.
- i. Të kontrollohet me mikroprocesor.
- j. Me frekuence 40kHz dhe diapason tensioni 40-120kV.
- k. Rryma e monoblokut të jetë deri në 7mA në fluoroskopi dhe deri në 65mA në radiografi.
- l. Rryma në fluoroskopi me goditje të jetë jo më e vogël se 12mA.
- m. Të jetë me gjenerator monofaze me tension 220-230V, me kompesim automatik të linjës.
- n. Fuqia jo më pak se 3.5kĒ.
- o. Diapazoni i mAs jo më pak se: 1-250mAs.
- p. Të ketë lëvizje vertikale të motorizuar deri në 45cm.
- q. Lëvizja orbitale të arkut deri në 130°.
- r. Hapësira e përdorshme midis tubit të rrezeve X dhe intensifikuesit të imazhit, jo më pak se 72cm.
- s. Të ketë lëvizje horizontale deri në 210mm.
- t. Të ketë lëvizje lëkundese deri në ±12°.
- u. Thellësia e arkut jo më pak se 65cm.
- v. Kapaciteti termik i monoblokut, jo më pak se 880kJ.
- w. Të ketë filtrim total me të madh se 2.7mmAl
- x. Të ketë filtrim shtesë të fiksuar, jo më pak se 1 mmAl
- y. Shpërndarja termike e monoblokut, jo më pak se 60Ē
- z. Të jetë me kolimator virtual.
- aa. Anode rrotulluese më jo më pak se 3000 rmp.
- bb. Të ketë përmasa fokale 0.3*0.3mm me 0.6*0.6mm.

- cc. Diafragram të kontrollohet nga konsola e komandimit me rregullim të vazhdueshëm.
- dd. Të ketë dy mbyllëse paralele të diafragmës, me rrotullim dhe hapje të ndryshme.
- ee. Të jetë jo më pak se 9" dhe zmadhimi në të paktën 3 zona.
- ff. Grila e intensifikuesit të imazhit me raport jo më pak se 8:1.
- gg. Diametri i imazhit në dalje të jetë jo më i vogël se 19mm.
- hh. Raporti i kontrastit ndaj sipërfaqes së madhe të jetë: 23:1, 25:1, 30:1.
- ii. Efikasiteti kantik i gjurmimit të jetë sipas standartit IEC.
- jj. Faktori i konvertimit të jetë të paktën 240 Cd/m²/mR/s.
- kk. Mbyllësi i diafragmës deri në 40L/cm.
- ll. Të ketë jo më pak se 620 linja dhe frekuence 50 Hz.
- mm. Të jetë me persistence të ulët.
- nn. Raporti i aspektit të jetë 4:3 dhe brezi jo më pak se 14 MHz.
- oo. Të jetë me sensor CCD 1/2".
- pp. Të ketë modalitetet e funksionimit radiografi dhe fluoroskopi.

➤ *Modaliteti i fluoroskopit:*

- d. Të ketë teknikën me 1 pike për kontroll manual të tensionit dhe kontroll automatik të rrymës.
- e. Të ketë teknikën me 0 pika për kontroll automatik të rrymës dhe tensionit.
- f. Të mund të komandohen rrezet X në distance me pedal multifunksional.

➤ *Modaliteti Radiografi:*

- e. Të ketë teknikën 2 pika (Kv dhe mAs).
- f. Të mund të komandohen rrezet X në distance me kabull deri në 4 m.
- g. Të ketë komutues dore me shkallë të dyfishtë.
- h. Të paktën nivelet e mëposhtëme të sigurisë:
 - i. Temperatura maksimale e tubit të rrezeve X.
 - ii. mA minimale dhe mA maksimale.
 - iii. Koha maksimale e ekspozimit.
 - iv. Rryma në filament.
 - v. Rrotullimi I anodës.
 - vi. Vetëkontroll të mikroprocesorit.

Të shoqerohet me të gjithë aksesoret e nevojshem për funksionimin normal të të gjithë parametrave të pajisjes.

2. Përparse plumbi.

Përparse plumbi përberë nga:

- iv. *Xhaketë plumbi, permasa L. Të dy anët e xhaketës për mbrojtje nga rrezet radioactive, shtresa e përparme mbrojtëse jo më pak se 0.50mm, shtresa e mbrapme mbrojtëse jo më pak se 0.25mm.*
- v. *Fund plumbi, përmasa L. Të dy anët e fundit për mbrojtje nga rrezet radioactive, shtresa e përparme mbrojtëse jo më pak se 0.50mm, shtresa e mbrapme mbrojtëse jo më pak se 0.25mm.*
- vi. *Qafore plumbi për mbrojtjen nga rrezet radioactive, shtresa mbrojtëse jo më pak se 0.50mm, qaforja e përshtatëshme për përmasat 38-46, lartësia e qaforës 6 cm.*

3. Pajisje pneumatike për ndaljen e gjakut.

- i. *Të jetë me manometer me shkallë jo më pak se 690 mmHg.*
- ii. *Të ketë pompë pneumatike për fryrjen.*
- iii. *Të jetë me dy mansheta, për krah dhe në kofshe.*

Paisjet e mesiperme duhet të jene cilesore dhe të certifikuara sipas standarteve CE.

Paisjet duhet të kene garanci per te pakten nje vit duke filluar nga data e furnizimit te tyre.

Afati i levrimit te mallrave duhet te jete brenda dy muajve duke filluar nga data e lidhjes se kontrates se furnizimit. Sipermarresi duhet te siguroje transportin deri ne montimin dhe venien ne funksion te paisjeve.

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “*Saer Medical*” shpk rezulton se në sistemin e prokurimeve elektronike ka depozituar dokumentacionin si më poshtë:

- Dokumenta me emërtimin “Katalog 1, Katalogu 2, Katalogu 3, të markuar”,
- Dokumenta me emërtimin “Katalogë” dokument në gjuhë të huaj dhe i përkthyer noterizuar në gjuhën shqipe;

III.1.5. Në nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “*Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara*”.

III.1.6. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*”

Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.7. Në nenin 27, “Kontratat e mallrave” pika 3 e VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.1.8. Ndërsa në nenin 27 pika 6, gërma “b” të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, “Kontratat e Mallrave” parashikohet shprehimisht se: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit*”. (b) *“dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike”* .

III.1.9. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.1.10. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit

me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...].”

III.1.11. Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterit për katalogët ka paraqitur dokumentin katalog të përkthyer të noterizuar në gjuhën shqipe, si edhe ofertën ekonomike me të dhënat sipas tabelës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Nga verifikimi i këtyre dokumentave konstatohet se ka disa mangësi dhe mospërputhje në lidhje me parametrat sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit konkretisht në lidhje me specifikimet teknike të pajisjes mjeksore.

III.1.12. Konstatohet nga verifikimi i dokumentit me emërtimin katalog të përkthyer, ku janë përcaktuar nga operatori ekonomik “Saer Medical” shpk të dhënat sipas tabelës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit shtojca 9 e modifikuar “Specifikimet Teknike”, konstatohet se për artikullin C-ARM të kërkuar nga autoriteti kontraktor, është ofruar nga operatori ekonomik ankimues një produkte me të dhëna të ndryshme nga ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit në specifikimet teknike, nga verifikimi i parametrave të produktit të ofruar nga operatori ekonomik ankimues vërehet se ka mospërputhje në elementët (si p.sh. *Të ketë lëvizje vertikale të motorizuar deri në 45cm, ndërkohë në katalog është 400 mm; Të ketë lëvizje horizontale deri në 210 mm, ndërkohë në katalog është 200 mm; Të ketë lëvizje lëkundese deri në ±12 o, ndërkohë në katalog është ±10.5 o; Raporti i kontrastit ndaj sipërfaqes së madhe të jetë: 23:1, 25:1, 30:1, ndërkohë në katalog është 33:1, 42:1, 61:1; Faktori i konvertimit të jetë të paktën 240 Cd/m²/mR/s, ndërkohë në katalog është 235 Cd/m²/mR/s; Të jetë me sensor CCD 1/2, ndërkohë në katalog është Sensor CMOS etj.*). Nga sa më sipër rezulton se produkti me të cilin ka ofertuar operatori ekonomik ankimues ka parametra të ndryshëm, të cilët rezultojnë të jenë nën minimumin e parametrave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, duke mos përmbushur kështu kriteret dhe specifikimet teknike të hartuara dhe të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit, aq më tepër që nga shqyrtimi i pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues në ankesë nuk rezulton që ky i fundit të ketë paraqitur argumenta apo prova shtesë se mos përmbushja e parametrave të kërkuar nga autoriteti kontraktor si më sipërcituar nuk do të ndikonin në funksionimin e pajisjes, gjithashtu operatori ekonomik ankimues në ankesën drejtuar Komisionit Prokurimit Publik ka patur momentin procedural të kërimit të ekspertizës së posaçme për të vërtetuar se pajisja me parametrat që ai ka ofertuar në këtë procedurë prokurimi në funksion të realizimit të shërbimit nuk ndryshon nga pajisja e kërkuar nga autoriteti kontraktor, gjë të cilën nga shqyrtimi i ankesës rezulton se ky operator ekonomik nuk e ka kërkuar një gjë të tillë. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se nga ana e ankimuesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti

kontraktor ka përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit, pasi ankimesi është i detyruar të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, pra të paraqesë çdo dokumentacion që përmban të dhëna dhe elementë që janë gjykuar të nevojshëm dhe të domosdoshëm nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat standarte të tenderit si në rastin konkret specifikimet teknike të produktit objekt prokurimi. Komisioni, referuar dhe dokumentave standarde të tenderit që përcakton se *“Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria apo përmbushja e specifikimeve teknike sipas dokumentave standarte të tenderit, operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogët dhe produktet (kodet) të jenë të markuara. Të dallohet qartë përputhja e specifikimeve teknike me katalogët e produkteve të paraqitura, ku të vërehen qartë karakteristikat teknike të mallit që do të ofrohet me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike sipas përcaktimeve në dokumentat e tenderit”*. K.P.P, gjykon se katalogët e paraqitur nga operatori ekonomik ankimesi *“Saer Medical”* shpk, nuk i përmban të gjitha të dhënat apo specifikimet teknike të mallrave apo produkteve të kërkuara, sipas përcaktimeve të bëra nga autoriteti kontraktor në shtojcën 9 *“Specifikimet teknike”*, të dokumentave standarte të tenderit. Katalogjet - referuar edhe legjislacionit në fuqi - i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin konkret nuk mund të vërtetohet se operatori ekonomik ankimesi, ka kapacitete për të ofruar produktet e kërkuar nga autoriteti kontraktor, sepse katalogjet e paraqitura nga ky operator ekonomik ankimesi për produktet, objekt prokurimi, nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, ankimesi nuk ka kapacitet për të ofruar produktet e kërkuara nga autoriteti kontraktor, sepse Katalogjet për mallrat objekt prokurimi të paraqitur nga ankimesit, nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

III.1.13. Sa më sipër, KPP sqaron se, mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorëve ekonomikë të pavlefshme. Operatorët ekonomikë duhej të dorëzonin të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik *“Saer Medical”* shpk në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk konsiderohet i vlefshëm.

III.1.14. KPP gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimesi do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon*

vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me intepretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kritereve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Sa më sipër Komisioni gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk plotëson specifikimet teknike në lidhje me produktet sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, duke mos dëshmuar se gëzon kapacitete për realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Saer Medical” sh.p.k nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Saer Medical” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-71877-09-15-2020, me objekt “Blerje pajisjesh për Shërbimin e sallave të Ortopedisë në SUT”, me fond limit 7.979.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 14.10.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës..

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e tjerë të procedurës së mësipërme të prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1437 Protokoli, Datë 06.11.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri